



Prishtinë, 26. 10. 2011  
Referenca: Nr. 02/2011

#### KOMISIONI SHQYRTUES

Komisioni Shqyrtues në përbërje të:

1. Ylber Aliu, Kryesues
2. Elmaze Nuhi, Anëtare
3. Mejrem Çernobregu, Anëtare

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA REGULATORNI URED ZA VODOVOD I OTPAD WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE	
Nr. prot./Prot. Br./Prot. No.	532
Njësi/Çetësia/Unit.	KSH
Nr. shkr./Uptis. Br./Rec. No.	
Data/Datum/Date	26.10.2011
PRISHTINË - PRISTINA - PRISHTINA	

#### Në çështjen e ankesës së:

Kompanisë Regionale të Mbeturinave, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A (më tutje: KRM, "Uniteti", Mitrovicë). Adresa: "Vëllezërit Draga", Mitrovicë, Republika e Kosovës, me dy njësitë tjera në Vushtrri dhe Skenderaj. (Ankesa e datës: 24. 12. 2010 me Nr 480).

#### Kundër vendimit të:

ZRRUM-it Nr 480 të datës: 07. 12. 2010 me të cilën vendim ka refuzuar kërkesën e KRM, "Uniteti", Mitrovicë, për lëshimin e Licencës së Shërbimit për Operimin e Deponisë së Mbeturinave, "Gërmova", për shkak se, sipas ZRRUM-it, KRM, "Uniteti", Mitrovicë, nuk i ka përmbushur të gjitha kriteret ligjore për të marrë Licencën e Shërbimit (Vendimi i ZRRUM-it i datës: 07. 12. 2010 me Nr 480).

#### BAZA JURIDIKE

1. Neni 34 i Ligjit për Ndryshimin e Rregullorës së UNMIK-ut 2004/49 mbi Vepimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësijellës, Kanalizimit dhe të Mbeturinave (më tutje: Ligji Nr. 03/L-086) dhe neni 10 i procedurës së Komisionit shqyrtues.

#### PËRMBLEDHJA E FAKTEVE

2. Përmes vendimit të datës: 07. 12. 2010 me Nr 480 ZRRUM ka refuzuar kërkesën e KRM, "Uniteti", Mitrovicë, për lëshimin e Licencës së Shërbimit për Operimin e Deponisë së Mbeturinave, "Gërmova". Vendimin për mos lëshimin e Licencës së Shërbimit për KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A, ZRRUM-i e bazon në nenin: 5. 2, të Ligjit Nr 03/L-086, dhe në nenin: 45. 2, të Rregullës për Licencimin e Operatorëve të Deponive të Mbeturinave (më tutje: R01/DM).
3. Në vendimin për mos lëshimin e Licencës së Shërbimit, ZRRUM pohon se, pas shqyrtimit të aplikacionit, dokumentacionit, informatave tjera lidhur me të, ka konstatuar se, KRM, "Uniteti", Mitrovicë, nuk i ka përmbushur të gjitha kriteret ligjore për të marrë Licencën e Shërbimit.
4. Këto mos përmbushje konsistojnë, sipas ZRRUM-it, në: I. Lista e Tarifave e proceduar nuk korrespondon me Aplikacionin e parashtruar. II. Mungon vlerësimi i plotë i banorëve në Zonën e Shërbimit (në pajtim me nenin: 19, pika c, R01/DM). III. Mungon dokumenti zyrtar i pronësisë apo dhënies në shfrytëzim të pronës nga pronari (në pajtim me nenin: 20, R01/DM). IV. Mungojnë lejet relevante nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe nga Instituti i Shëndetit Publik (në pajtim me nenin: 24. 2 dhe 24. 3, R01/DM). V. Struktura e organizimit nuk është sipas kërkesave (me nenin: 29, pika g dhe j, të R01/DM). VI. Mungojnë procedurat e punës, të kodifikuara sipas kërkesave administrativo-juridike (në pajtim me nenin: 29. 4, 29. 5, 29. 6, R01/DM). VII. Mungon plani i mbylljes së Deponisë (në pajtim me nenin: 31, R01/DM). VIII. Dokumentet e parashtruara të sigurimit nuk korrespondojnë me Listën e Pajisjeve të proceduara. IX. Mungon Garancioni i Zbatimit (në pajtim me nenin 33, R01/DM). X. Mungojnë të gjitha kërkesat (sipas nenit: 35, R01/DM). XI. Mungojnë dëshmitë për tatimet në pronë (në pajtim me nenin: 36, R01/DM). XII. Mungesa e rrymës dhe telefonit në Deponi.
5. Me datë: 24. 12. 2010 KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A, brenda afatit kohor ligjor prej 15 (pesëmbëdhjetë), ashtu sikurse e parasheh neni 34. 1 i Ligjit Nr. 03/L-086, ka parashtruar ankesë në Komisionin Shqyrtues kundër vendimit të ZRRUM-it.
6. Në ankesën e parashtruar për Komisionin Shqyrtues, KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A, pohon se, e ka ofruar Listën e Tarifave në fuqi në bazë të cilave operon Deponia, "Gërmova", Koshtovë, Mitrovicë, si pjesë përbërse e KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A. Përpos kësaj, KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A, pohon se, ka dorëzuar shkresën për vlerësimin e plotë të banorëve në Zonën e Shërbimit (në pajtim me nenin: 19, pika c, R01/DM).
7. KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A, pohon se, ka dorëzuar shkresën në bazë të së cilës vërtetohet që Deponia, "Gërmova", Koshtovë, është pronë e KK-Mitrovicë në shfrytëzim të kësaj prone nga ana e KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A, dhe gjithashtu ekstraktin nga fletë posedimi, kopjen e planit si dhe kopjen e planit më të detajuar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster, pronë – Mitrovicë.

8. KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A, thotë se, ka dorëzuar kërkesën e lejes relevante si për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit, si për Institutin e Pavarur të Minierave dhe Mineraleve, e ka bërë kërkesën edhe për Institutin e Shëndetit Publik, por ZRRUM-i ju ka thënë se s'ka nevojë të bëhet kërkesa për Institutin e Shëndetit Publik ashtu që kërkesën nuk e kanë dërguar fare pasi s'ka pas nevojë.
9. Në ankesë KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A, vazhdon se, struktura e organizimit është në bazë të Rregullës mbi sistematizimin e vendeve të punës dhe organogramit në fuqi për Deponin, "Gërmova", Koshtovë, në Deponi punojnë edhe dy punëtor fizik (duhet të përmirësohet aplikacioni edhe me dy punëtor fizik). Përpos strukturës së organizimit, KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A, pohon se, sa i përket procedurës së punës të kodifikuar sipas kërkesave administrativo-juridike e në pajtim me nenin: 29. 4, 29. 5, 29. 6, R01/DM.
10. Gjithashtu, në ankesë KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A, pohon se sa i përket planit të mbylljes së Deponisë, plani i mbylljes së deponisë kuartë është parapa në projektin e ndërtimit dhe mbarëvajtjes së punës së Deponisë si dhe mbylljes së Deponisë sipas këtij plani të prezentuar së bashku me aplikacionin si dhe dokumentet e kërkuara (Ky projekt është dorëzuar në tri kopje me të gjitha sqarimet dhe hartat përcjellëse). Sa i përket dokumenteve të sigurimit, në ankesë KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A, pohon se, dokumentet e parashtruar të sigurimit janë po të njëjtat që ju kemi prezentuar së bashku me aplikacion dhe janë për Bomagun dhe Caterpilari tipi 950 g donacione të Danidës dhe i kanë policat e sigurimit.
11. Poashtu KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A, pohon se sa i përket Garancionit të zbatimit në pajtim me nenin: 33, R01/DM sqarimet i keni në shkresën bashkangjitur në kërkesë. Gjithashtu, KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A, pohon se, sipas nenit: 35, R01/DM ju kemi dorëzuar të gjitha kërkesat së bashku me dokumentet e kërkuara me rastin e aplikimit për Licencë për Deponi, në përputhje me nenin: 35, R01/DM, ju prezentojmë të gjitha dokumentet e kërkuara në bazë të pikave të cekura në nen. Në pajtim me nenin: 36, R01/DM, KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A, pohon se, ka dëshmi për tatimin në pronë, e cila dëshmi është pjesë përbërëse e ankesës.
12. Krejt në fund, KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A, në ankesë, pohon se, Deponia, "Gërmova" është e pajisur me dy gjeneratorë dhe me anë të këtyre gjeneratorëve furnizohet me rrymë. Sa i përket telefonit në Deponi menaxheri me stafin janë të pajisur me numrat e telefonisë mobile IPKO dhe me anë të këtyre telefonave komunikojnë, bashkangjitur në shkresë është shkresa skjaruese.

#### PREZANTIMI I ARGUMENTEVE

13. Komisioni shqyrtues në takimin e punës të mbajtur me datë: 28. 09. 2011 ka vendosur të ofrojë mundësin përfaqësuesit të ZRRUM-it dhe KRM, "Uniteti", Mitrovicë në Komisionin shqyrtues të dëgjojë argumentet e tyre përkitazi me vendimin dhe ankesën.
14. Në dëgjimin e mbajtur nga Komisioni shqyrtues me datë: 17. 10. 2011, përfaqësuesja e ZRRUM-it ka arsyetuar vendimin për mos lëshimin e Licencës së Shërbimit për Operimin e

Deponisë së Mbeturinave, "Gërmova", duke potencuar se "Dokumentacioni nuk është i kompletuar".

15. Këto argumente u kundërshtuan nga përfaqësuesja e KRM, "Uniteti", Mitrovicë. Duke kundërshtuar argumentet e ZRRUM-it të cekura në vendim, përfaqësuesja e KRM, "Uniteti", Mitrovicë ka cekur një nga një pohimet e cekura në ankesë.
16. Pra, palët nuk kanë lëvizur nga pozicionet e tyre, dhe kanë përsëritur të njëjtat argumente të vendimit, përkatësisht ankesës.

#### VLERËSIMI

17. Komisioni shqyrtues vlerëson se ankesa e KRM, "Uniteti", Mitrovicë është bërë brenda afatit kohor ligjor, mirëpo për shkak të mungesës së emërimit të Kryesuesit të Komisionit shqyrtues nga Kuvendi, është shtyrë shqyrtimi i kësaj ankesë deri më tani.
18. Komisioni shqyrtues, pas shqyrtimit të gjithanshëm të dokumentacionit, arsytimit të ZRRUM-it dhe deklaratave të dhëna nga përfaqësuesit e të dyja palëve vlerëson se disa nga argumentet e cekura në arsyetimin e ZRRUM-it për mos lëshimin e Licencës së Shërbimit për Operimin e Deponisë së Mbeturinave, "Gërmova", nuk qëndrojnë dhe disa tjera vazhdojnë të qëndrojnë.
19. Sa i përket argumentit se mungon lista e plotë e banorëve në zonën e shërbimit nuk qëndron nga se Komisionit shqyrtues i është ofruar dokumenti ku ceket qartazi lista e plotë e banorëve të shërbimit. Kjo informatë është ofruar përmes shkresës me Nr 646 të datës: 15. 12. 2010.
20. Ndërsa sa i përket argumentit se nuk është paguar tatimi në pronë nuk qëndron. Kjo sepse është prezantuar shkresa nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës ku vërtetohet se ky obligim është kryer. Shkresa është lëshuar nga Komuna e Mitrovicës me datë: 09. 11. 2010.
21. Gjithashtu KRM, "Uniteti", Mitrovicë, në takimin e katërt të punës ka dorëzuar një kopje të planit të biznesit.
22. Sa i përket telefonit, KRM, "Uniteti", Mitrovicë ka prezantuar shkresën ku argumenton se përdorë numra të telefonis mobile IPKO. Sa i përket energjisë elektrike, KRM, "Uniteti", Mitrovicë ka prezantuar po ashtu një shkresë me Nr 650 të datës: 20. 12. 2010 ku argumenton se ka në përdorim dy gjenerator për këtë qëllim; është prezantuar edhe plani për elektrifikimin, përkatësisht asfaltimin e rrugës deri te Deponia, shkresa me Nr 433 të datës: 08. 11. 2010.
23. Sa i përket çështjes së tarifave, KRM, "Uniteti", Mitrovicë fillimisht ka dorëzuar shkresën e datës: 25. 10. 2010, e mandej gjatë takimeve të punës së Komisionit shqyrtues ka dorëzuar edhe shkresën me Nr 651 të datës: 19. 10. 2011 ku informon lidhur me tarifat të cilat është duke i aplikuar.
24. Argumenti tjetër i ZRRUM-it se mungojnë lejet relevante nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik qëndron pjesërisht.

Komisionit shqyrtues i është prezantuar kërkesa me Nr 540 e datës: 21. 09. 2010 e bërë në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (në bazë të rekomandimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) për lëshimin e lejes relevante. Mirëpo si e tillë kjo kërkesë nuk mjafton nga se neni 24. 2, i Rregullës R01/DM përcakton se *“Aplikuesi duhet të ofrojë dëshminë e dokumentuar se janë nxjerrë licencat dhe lejet relevante që kërkohen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor”*. Një dëshmi e tillë se janë nxjerrë licencat dhe lejet nuk është ofruar. Ndërsa sa i përket lejes nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik kjo nuk ka qenë e nevojshme pasi që vet ZRRUM-i e ka liruar nga ky obligim.

25. Ndërsa sa i përket çështjes së pronësisë janë dorëzuar dy shkresa. E para, në njërën prej shkresave (dhe ankesë) KRM, “Uniteti”, Mitrovicë pohon se *“Deponia ‘Gërmova’ në Koshtovë është pronë e Komunës në shfrytëzim të KRM, ‘Uniteti’, Mitrovicë”*. E dyta, është dorëzuar një kopje e dokumentit, e lëshuar prej Komunës së Mitrovicës, ku vërtetohet kjo. Mirëpo në asnjërin prej këtyre dy dokumenteve nuk saktësohet afati kohor i shfrytëzimit.
26. Procedurat e punës nuk janë në bazë të kërkesave të nenit 29. 2 të R01/DM. Janë dy fenomene kryesore që vërehen në këtë rast. E para, disa procedura nuk janë të detajizuara. Neni 29. 2 i Rregullës R01/DM përcakton se *“Aplikuesi duhet të ofrojë përshkrimin e detajizuar të procedurave të cilat duhet të përdoren për të pranuar, marrur dhe për të vëzhguar Mbeturinat e Ngurta Komunale të pranuar...”*. E dyta, disa procedura tjera mungojnë tërësisht. Komisioni shqyrtues ka gjetur se mungon procedura e *“Pranimi të mjeteve transportuese që bartin mbeturina në portën hyrëse të Kompleksit”*, ashtu siç e parasheh neni 29. 2, pika a, e Rregullës R01/DM.
27. Struktura e organizimit nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 29. 1, të Rregullës R01/DM. Në organogramin e prezantuar para Komisionit shqyrtues mungojnë këto pozita të punës të cilat duhet të jenë pjesë e organogramit: I. Mbikqyrësi i Deponisë së Mbeturinave (neni 29. 1, pika b); II. Kryepunëtori i Ndrimit i Deponisë së Mbeturinave (pika d); III. Punëtori i Lartë i Peshores (pika e); IV. Punëtori sinjalizues (pika f); V. Punëtor për Shpërndarjen e Naftës dhe Lubrifikantëve (pika k); VI. Mekanik i Mirëmbajtjes dhe Salduesit (pika m); VII. Sekretar – recepcionist (pika n); VIII. Punëtor për Shërbimet ndaj Konsumatorëve (o); dhe, IX. Zyrtar i Prokurimit (pika p).
28. Kërkesat e parapara në nenin 35 të Rregullës R01/DM lidhur me *“Dokumentet e kërkuara të biznesit së bashku me Aplikacionin”* mungojnë. Sa i përket argumentit rreth organogramit (të prezantuar në paragrafin 27) dhe kërkesave të parapara në bazë të nenit 35 të Rregullës R01/DM, arsyetimi i përfaqësues së KRM, “Uniteti”, Mitrovicë, në Komisionin shqyrtues ka qenë se:

*“Deponia e mbeturinave ‘Gërmova’ është në kuadër të KRM, ‘Uniteti’, Mitrovicë, dhe për këtë arsye vendet e punës që mungojnë në organogramin e prezantuar mbulohen nga punëtorët e KRM, ‘Uniteti’, Mitrovicë, dhe se, dokumentet e kërkuara në bazë të nenit 35 të Rregullës janë dorëzuara dhe po ato të KRM, ‘Uniteti’, Mitrovicë”*.

29. Mungon plani i mbylljes së Deponisë. Përkatësisht aplikuesi ka parashtruar projektin e mbylljes, i cili është mjaftë i avancuar, por që kërkon ende të specifikohet dhe të shndërrohet në plan për mbylljen e Deponisë, ashtu siç e kërkon neni 31 i Rregullës R01/DM, ku përcakton se:

*"Aplikuesi duhet të parashtoj kopjen e planit për mbylljen e Deponisë së Mbeturinave që ka të bëjë me:*

- (a) Mbylljen e cilës do qeli aktive si pjesë e aktiviteteve të rregullta operative; dhe
- (b) Mbylljen e Deponisë së Mbeturinave në momentin kur të arrijë kapacitetin e plotë ose përherë të mbyllet për cilën do qoftë arsye".

30. Mungojnë sigurimet dhe garancionet financiare të kërkuara në bazë të nenit 32, të Rregullës R01/DM. Komisioni shqyrtues i janë sjellur sigurimet e mjeteve transportuese. Mirëpo jo edhe sigurimet e punëtorëve. Në anën tjetër, neni 32. 3, përcakton se:

*"Mbulimi i sigurimit duhet të përfshijë të gjithë të punësuarit dhe të gjitha mjetet transportuese vetanake, të huazuara ose të lëshuara me qira që shfrytëzohen nga Operatori i Deponisë së Mbeturinave për të përmbushur obligimet e tij që kanë të bëjnë me ofrimin e Shërbimeve për Deponimin e Mbeturinave".*

#### PËR KËTO ARSYE

31. Komisioni shqyrtues në pajtim me nenin 34. 4 Ligjit Nr 03/L-086 dhe me nenin 10 të procedurës:

#### VENDOS

1. Mbetet në fuqi vendimi ZRRUM-it me Nr 480 i datës: 07. 12. 2010.
2. Hedh poshtë ankesën e KRM, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A me Nr 02 të datës: 08. 11. 2010.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e lëshimit.

**Këshillë juridike:** Në bazë të nenit 35 të Ligjit Nr. 03/L-086, palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrojnë ankesë në Gjyqin Kompetent për shqyrtim gjyqësor brenda një (1) muaji nga data kur ofruesit të shërbimeve i është dorëzuar me shkrim vendimi përkatës nga Komisioni shqyrtues.

Kryesuesi i Komisionit shqyrtues:

Ylber Aliu

